



INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT  
INSTITUCIJA OMBUDSMANA  
OMBUDSPERSON INSTITUTION

# PËRMBLEDHJE E RAPORTIT VJETOR 2022

*“Të drejta dhe barazi për të gjithë”*



Republika e Kosovës · Republika Kosovo · Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit · Institucija Ombudsmana · Ombudsperson Institution



---

# PËRMBLEDHJE E RAPORTIT VJETOR 2022

---

*“Të drejta dhe barazi për të gjithë”*

Maj, 2023



## Tabela e përmbajtjes

1.Fjala e Avokatit të Popullit .....	5
2.Si i mbrojmë ne të drejtat e njeriut? .....	8
3.Puna e Avokatit të Popullit në numra .....	9
4.Besueshmëria e publikut në Institucionin e Avokatit të Popullit .....	11
5.Promovimi i të drejtave të njeriut gjatë vitit 2022.....	12
6.Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	12
7.Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave të njeriut .....	13
1. Dinjiteti i njeriut dhe integriteti personal .....	13
2. Liria e lëvizjes .....	14
3. Mbrojtja e pronës .....	14
4. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta e lirisë dhe e sigurisë ...	15
5. E drejta për mjete juridike .....	15
6. E drejta e privatësisë.....	16
7. E drejta e martesës dhe familjes.....	16
8. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë .....	17
9. Liria e asociimit.....	17
10. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit .....	18
11. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale .....	19
12. Liria e shprehjes, e drejta e qasjes në dokumente publike dhe liria e mediave .....	20
13. Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes .....	21
14. E drejta për arsimim .....	21
15. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.....	22
8.Mbrojtja nga diskriminimi.....	23
9.Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e torturës .....	25
10.Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.....	26
11.Barazia gjinore .....	28
12.Përgjegjësia për mjedisin jetësor .....	29
13.Të drejtat e komuniteteve joshumicë .....	30
14.Drejtësia tranzicionale .....	32
15.Mbikëqyrja e politikave legislative .....	33
16.Gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë e përmbledhur në disa konkluzione .....	34



# 1. FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT

Të nderuar shtetas dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

I angazhuar si zë i fuqishëm i qytetarëve në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të tyre nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përmes këtij raporti në mënyrë të përmbledhur do ta informoj publikun, qytetarët dhe institucionet për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Kosovës, bazuar në të gjeturat nga vlerësimi i ankesave të qytetarëve si dhe nga puna e angazhimi ynë gjatë vitit 2022. Duke besuar se adresimi ynë, edhe përmes këtij raporti, do të ndikojë që gjendja e të drejtave të njeriut të përmirësohet me respektim të plotë, si parakusht i çdo shteti demokratik e ligjor, çfarë është edhe vendi ynë.

Gjithashtu kjo përmbledhje e raportit vjetor do ta prezantojë punën e Institucionit të Avokatit të Popullit në realizimin e mandatit në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, me instrumente ndërkombëtare dhe me ligjet në fuqi.

Nga vlerësimi i përgjithësim i të drejtave të njeriut për vitin 2022, mund të them se, pavarësisht se ka përmirësime në respektim të të drejtave dhe të lirive të njeriut, progresi nuk është i mjaftueshëm dhe nuk është në përputhje me të drejtat dhe as me liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës së vendit tonë. Ky konstatim bazohet në ankesat e qytetarëve, që përgjatë vitit 2022 janë 1595 ankesa, të parashtruara nga qytetarët në Institucionin e Avokatit të Popullit, me pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut nga autoritetet publike.

Viti 2022 ishte i ndërlidhur me fushatën “Barazi për të gjithë”, ku vëmendje e posaçme i është kushtuar pozitës së vështirë të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu shqetësuese mbetet dhuna në baza gjinore dhe në familje, për shkak të masave të pamjaftueshëm për parandalim dhe mbrojtje; vështirësitë në realizimin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave si pasojë e zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe mungesës së një mekanizmi ligjor për mbrojtjen e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm kohor; diskriminimi; mospërmbushja e detyrimeve pozitive që ka shteti për respektimin e të drejtave të fëmijëve; e drejta për jetë; dështimet e vazhdueshme për ta adresuar përgjegjësinë për mjedisin jetësor etj.

Edhe në këtë vit jemi angazhuar me shumë përkushtim në vetëdijesimin e qytetarëve dhe të institucioneve për rëndësinë e të drejtave dhe të lirive themelore si dhe rolin dhe mandatin e Avokatit të Popullit, duke u dëshmuar si institucion i pavarur kushtetues, që rol kryesor ka mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore. Më gëzon fakti se Avokati i Popullit vazhdon të mbetet institucioni më i besueshëm në vend dhe në rajon, niveli i besueshmërisë së qytetarëve, sipas vlerësimit nga Barometri Ballkanik, tek Avokati i Popullit ka arritur në 68%. Kjo më inkurajon që angazhimi im dhe i Institucionit të Avokatit të Popullit të jetë edhe më dinamik duke qëndruar fuqishëm në mandatin dhe rolin që kemi.

Çështjet që në vitin 2023 Avokati i Popullit do t'u kushtojë vëmendje të posaçme lidhen me sigurinë dhe me shëndetin në punë; me përmbushjen e detyrimeve që ka shteti në raport me krimet e luftës; me qasjen në drejtësi për viktimat; me të drejtën për të ditur dhe dokumentimin e së kaluarës; me të drejtat në arsim; me gjuhën e urrejtjes; me pozitën e gruas në relacion me

të drejtat pronësore dhe shumë çështje të tjera, me qëllim të avancimit të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Në përmbushje të mandatit dhe të detyrave, zotohem se do të angazhohem maksimalisht ta mbroj dhe ta promovoj respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore, ashtu që të ketë të drejta dhe barazi për të gjithë.

*Naim Qelaj*

*Avokat i Popullit*

## Shkurtesat:

<b>AGK</b>	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit
<b>MKP</b>	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës
<b>MPJD</b>	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
<b>SISh</b>	Sistemi Informativ Shëndetësor

## Shënim:

*Ky raport është përmbledhje e shkurtuar e Raportit vjetor të vitit 2022, i cili i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës.*



## 2. SI I MBROJMË NE TË DREJTAT E NJERIUT?

Avokati i Popullit është institucion i pavarur kushtetues. Puna e Avokatit të Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit. Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe janë të përcaktuara me kushtetutë dhe me ligj.

Avokati i Popullit mbron të drejtat e njeriut dhe liritë themelore përmes hetimit të ankesave të pranuar nga personat fizik dhe juridik, të cilët pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga institucionet publike. Me qëllim që të jetë sa më afër qytetarëve, përpos Zyrës Qendrore në Prishtinë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka edhe 8 zyre rajonale. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas.

### a. Çfarë mbrojmë ne?

Avokati i Popullit mbron të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të përcaktuara me Kushtetutë, me Konventat Ndërkombëtare nga neni 22 i Kushtetutës dhe me ligjet në fuqi. Kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në çdo të drejtë të njeriut, e cila u garantohet qytetarëve të Republikës së Kosovës.

### b. Si mbrojmë ne?

Pas hetimit të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, krahas veprimeve të tjera, Avokati i Popullit mund të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut, të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe, kur është e domosdoshme, të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e cenimit të të drejtave të njeriut.

### c. Kë e mbrojmë ne?

Secilin qytetar dhe shtetas i cili pretendon se të drejtat e tij janë cenuar nga institucionet publike. Përpos personave fizikë, edhe personat juridikë mund të paraqesin ankesa me pretendime për shkelje të të drejtave të tyre. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të iniciojë hetime edhe sipas detyrës zyrtare, mbi informacionet për të cilat në çfarëdo mënyrë vihet në dijeni.

### d. Kundër cilave akte mbrojmë ne?

Avokati i Popullit mbron të drejtat e njeriut ndaj të gjitha akteve, veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve publike. Avokati i Popullit mbron qytetarët edhe nga praktikat e përgjithshme, të cilat mund të paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore të tyre.


Për sa i përket sistemit gjyqësor, Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e këtij sistemi. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe as në procedura e tjera ligjore që janë duke u zhvilluar nëpër gjykata, përveç rasteve kur ka zvarritje të procedurave gjyqësore në trajtimin e rasteve.

### 3. PUNA E AVOKATIT TË POPULLIT NË NUMRA


Në vitin **2022**, Avokati i Popullit trajtoi gjithsej **1595** ankesa, në të cilat ishin të përfshirë **2799** persona si ankues.

Sipas përkatësisë etnike,


**1441** ankues ishin shqiptarë,



Autoritetet publike ndaj të cilave më së shumti u drejtuan ankesa ishin



### Numri i ankesave për shkeljen e të drejtave




Për arsye të ndryshme, **910** ankesa u shpallën si të papranueshme. Mosshfrytëzimi i mjeteve juridike dominon si arsye për papranueshmërinë e ankesave.

Krahas ankesave, Avokati i Popullit inicioi edhe **42** hetime sipas detyrës zyrtare.

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka dhënë gjithsej **646** rekomandime.

**Në tabelën në vijim janë të paraqitura në mënyrë grafike të dhënat mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit.**



## 4. BESUESHMËRIA E PUBLIKUT NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

Si rezultat i angazhimit dhe i përkushtimit në promovimin dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të vlerësohet si institucioni më i besuar në vend dhe më gjerë.



Sipas Raportit të Barometrit të Ballkanit, të publikuar më 24 qershor 2022 nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, i cili ndër të tjerash është një hulumtim mbi perceptimin e opinionit të publikut mbi besueshmërinë dhe pavarësinë e institucioneve publike, 68% e të anketuarve i besojnë Institucionit të Avokatit të Popullit.



Besueshmëria në institucione publike

Në Kosovë, 68% e të anketuarve i besojnë Institucionit të Avokatit të Popullit (39% në 2020, një ngritje me 29%)

Pavarësia dhe ndikimi politik në institucionet publike

Në Kosovë, 60% e të anketuarve besojnë se Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur nga ndikimi politik (ky vlerësim në vitin 2020 ishte 32%)

Efektiviteti i mbikëqyrjes së Qeverisë nga institucionet relevante dhe përgjegjshmëria e saj ndaj qytetarëve

Kosova kryeson në këtë fakt, ku 63% e të anketuarve konfirmojnë se Institucioni i Avokatit të Popullit është i aftë ta bëjë mbikëqyrjen e Qeverisë dhe ta bëjë atë të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

## 5. PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT GJATË VITIT 2022

Avokati i Popullit ushtron mandatin e promovimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të ngritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi të drejtat e njeriut, të opinionit publik dhe të institucioneve publike në vend.

Gjatë viti 2022, Avokati i Popullit ka zhvilluar në 11 komuna fushatën “Barazi për të gjithë”. Qëllimi i kësaj fushate ka qenë: rritja e ndërgjegjësimit të publikut për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, informimin e publikut mbi rolin dhe mandatin e IAP-së si dhe identifikimi i problemeve që reflektojnë në të drejtat e njeriut.

Me qëllim të edukimit mbi të drejtat e njeriut dhe promovimit të rolit të IAP-së, në 35 shkolla fillore dhe të mesme është organizuar fushata “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”. Po ashtu, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka mbajtur 4 ligjërata me studentë të universiteteve publike dhe private në vend.

Gjatë vitit janë shënuar ditët ndërkombëtare: Ditës Ndërkombëtare Zero Diskriminim; Mbledhja e të dhënave dhe raportimi i të dhënave në sektorin shëndetësor; E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe zgjidhja efektive e zvarritjeve të procedurës gjyqësore; Ujërat, e drejtë e njeriut – mbikëqyrja dhe llogaridhënia; Sfidat në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Sfidat e personave me aftësi të kufizuara.

Institucioni po ashtu ka kontribuar në zhvillimin e fushatave mediale të organizuara nga shoqëria civile, me qëllim të vetëdijësimit të publikut mbi respektimin e barazisë, të mosdiskriminimit dhe luftimin e dhunës në baza gjinore. Po ashtu, institucioni ka qenë i pranishëm në tryeza, në konferenca, në punëtori, në trajnime, në debate publike e takime konsultative me tematika të ndryshme mbi aspekte të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, të organizuara nga shoqëria civile, nga institucionet publike dhe nga organizatat ndërkombëtare. Ka publikuar mbi 20 deklaratat, ku përmes tyre ka adresuar çështje të ndryshme të trajtimit të të drejtave të njeriut në vend.

## 6. BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Bashkëpunimi me shoqërinë civile në drejtim të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta për avokim dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut ka vazhduar edhe në vitin 2022. Në kuadër të Forumit për Dialog mes Avokatit të Popullit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile janë mbajtur dy takime të rregullta të punës dhe një takim ad-hoc. Forumi ka shërbyer për diskutimin dhe adresimin e çështjeve sistematike me interes nga fusha e të drejtave të njeriut gjatë vitit 2022. Si rezultat i çështjeve të ngritura në Forum, Avokati i Popullit ka iniciuar hetim ex-officio për shkeljet e pohuara për të drejtat e njeriut.

Po ashtu, Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNWomen, në kuadër të Task-Forcës Avokuese joformale mbi Standardet e ndjeshme gjinore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Punës së denjë, kanë organizuar tri takime regjionale.

## 7. MBROJTJA DHE MBIKËQYRJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

### 1. Dinjiteti i njeriut dhe integriteti personal

Si bazë e të gjitha të drejtave të tjera, Avokati i Popullit e ka trajtuar me kujdes të veçantë dinjitetin e njeriut. Përtej ankesave të pranuar, Avokati i Popullit në secilin rast ka mbikëqyrrur me kujdes respektimin e dinjitetit njerëzor.

Për dinjitetin e njeriut, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar 23 ankesa, 14 prej të cilave i ka proceduar për hetime të mëtutjeshme. Në këto raste, Avokati i Popullit, krahas mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, ka ndërtuar standarde adekuate se si duhet shikuar, trajtuar dhe zbatuar kjo e drejtë nga autoritetet publike.



Lidhur me dinjitetin njerëzor, Avokati i Popullit në raportin e MKP-së për vizitën në Shtëpinë Rezidenciale për Persona me Aftësi të Kufizuar Mendore në Prizren, ndër të tjera konstatoi: 1. Kishte shkelje të dinjitetit të njeriut ndaj qytetarit me aftësi të kufizuara, i cili nuk kishte pasur mundësi të dilte në oborr të Shtëpisë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare. 2.Mungesa e kushteve elementare në Shtëpinë Rezidenciale për Persona me Aftësi të Kufizuar Mendore në Prizren paraqet cenim të dinjitetit njerëzor.



Avokati i Popullit po ashtu vlerësoi se trajtimi i padinjitetshëm dhe cenimi i konfidencialitetit të grave, posaçërisht i atyre me aftësi të kufizuara, në institucione shëndetësore paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.



Në Raportin ex officio nr. 577/2021, të drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Republikën e Kosovës, me fokus qasjen në informata dhe në shërbime në kontracëpsion, qasjen në abort dhe në kujdesin pas abortit, si dhe kujdesin për shëndetin e nënës, përveç të tjerash, Avokati i Popullit ka konstatuar se grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nuk u janë ofruar informata të duhura për gjendjen e tyre shëndetësore, duke mos u ofruar shërbime në mënyrë të dinjitetshme dhe duke mos u krijuar kushte për marrjen e shërbimeve të dinjitetshme me nevojat e tyre, me ç' rast u është cenuar integriteti i tyre si në aspektin psikik, ashtu edhe në atë fizik, në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së.



Avokati i Popullit ua rikujton autoriteteve përgjegjëse detyrimin që t'i ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar trajtim me dinjitet, mbrojtje të privatësisë dhe të konfidencialitetit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe shëndetësore, si të drejta të garantuara, që duhet të respektohen në institucione shëndetësore, si në ato publike, ashtu edhe në ato private.

## 2. Liria e lëvizjes

Avokati i Popullit ka pranuar 32 ankesa me pretendime për cenim të lirisë së lëvizjes, për 14 prej të cilave hapi hetime.

Sipas Avokatit të Popullit, vendosja e barrikadave në veriun e Republikës së Kosovës ka cenuar lirinë e lëvizjes për qytetarët që banojnë në pjesën veriore të Kosovës. Për sa i përket rastit të vendosjes së barrikadave, Avokati i Popullit ia ka tërhequr vëmendjen secilit autoritet që në kuadër të fushëveprimit të tij, me përgjegjësi kushtetuese e ligjore, në mënyrë të kujdesshme t'i harmonizojnë të gjitha veprimet në respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Avokati i Popullit me shqetësim i ka ndjekur vonesat e pajisjes me pasaporta të qytetarëve, si pasojë e mungesës së materialeve për prodhimin e pasaportave.



Avokati i Popullit konsideron se mungesa e materialit për shtypjen e pasaportave ka cenuar lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës.



Avokati i Popullit thekson se është e rëndësishme kyçe që në secilin rast institucionet të bëjnë planifikimet e duhura, në mënyrë që të mos vijë deri te situata ku qytetarët të mos kenë mundësi të pajisen me dokumente të udhëtimit dhe kështu të shkelet liria e tyre për lëvizje.

## 3. Mbrotjtja e pronës

Avokati i Popullit ka pranuar 130 ankesa, të cilat, në një formë, cenonin të drejtat pronësore të ankuesve. Numri më i madh i ankesave lidhur me të drejtën e pronës janë paraqitur për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore që kanë të bëjnë me kontestet pronësore, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore etj. Përgjithësisht problemet të cilat ndërlihen me administrimin e drejtësisë ua vështirësojnë qytetarëve realizimin e të drejtave të tyre pronësore.



Për sa i përket së drejtës në pronë, Avokati i Popullit, në raportin A. nr. 353/2021 lidhur me Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01. Nr. 110-2782 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, ka konstatuar se obligimi për pagimin e tarifës së taksës për transaksion të pronës së paluajtshme përbën shkelje të së drejtës pronësore, për shkak se një obligim i tillë nuk përcaktohet me ligj, me ç' rast i ka rekomanduar Komunës së Prishtinës shfuqizimin e rregullores që përcakton një gjë të tillë.



Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar ankesa të shumta për zvarritje të procedurave lidhur me rastet e pronës shoqërore, ku kompetente për vendosje është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Vonesat në vendosjen e këtyre rasteve shihen me shqetësim nga Avokati i Popullit, për shkak se cenojnë të drejtat pronësore të qytetarëve.

## 4. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta e lirisë dhe e sigurisë

Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe nuk ndërhyr në procedura ligjore, përveç ankesave që kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave në gjykimin e lëndëve gjyqësore.

Sikurse në vitet e kaluara, edhe në vitin 2022 shumica e ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit kanë të bëjnë me pretendimet për shkelje të gjyimit të drejtë dhe të paanshëm. Në numrin më të madh këto shkelje kanë ndodhur për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme. Në secilin rast kur Avokati i Popullit gjeti cenim të kësaj të drejte, duke u bazuar në kompetencat ligjore, kërkoi nga autoritetet gjyqësore ndërmarrjen e veprimeve për eliminimin e shkeljeve të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.



Edhe përkundër faktit se zvarritjet e procedurave gjyqësore paraqesin një prej shqetësimeve që Avokati i Popullit ka ngritur vazhdimisht dhe i ka rekomanduar Qeverisë dhe Kuvendit krijimin e një mekanizmi ligjor për kompensimin e shkeljeve të kësaj natyre, ende nuk ka asnjë hap në drejtim të zbatimit të këtij rekomandimi. Qytetarët, pavarësisht faktit se u cenohet kjo e drejtë, mbesin pa mbrojtje ligjore në drejtim të kompensimit të shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.



Përgjatë vitit 2022 Avokati i Popullit nuk ka marrë ndonjë ankesë lidhur me cenimin e së drejtës për liri dhe siguri. Mandatin e tij lidhur me mbrojtjen e kësaj të drejte, Avokati i Popullit e ka përmbushur përmes mbikëqyrjes së të drejtave të njeriut, duke realizuar një numër të konsiderueshëm të vizitave nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës. Gjatë këtyre vizitave janë realizuar intervista me personat e privuar nga liria, në disa raste ka pasur pretendime për shkeljen e së drejtës së lirisë, duke iu referuar vendimeve për paraburgim dhe zvarritjes së jashtëligjshme të procedurave gjyqësore, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë.

## 5. E drejta për mjete juridike

Lidhur me pretendimet për shkelje të së drejtës për mjete juridike, Avokati i Popullit ka pranuar 498 ankesa. Ankesat kishin të bënin me mospërgjigje të institucioneve ndaj kërkesave të parashtruara. Për 218 raste, të cilat i plotësuan kriteret, është hapur hetim. Numri më i madh i ankesave ishte i drejtuar ndaj institucioneve qendrore (155), pasuar nga institucionet lokale (78) dhe nga gjykatat (76).



“ Lidhur me të drejtën për mjete juridike, Avokati i Popullit, në Raportin ex officio nr. 412/2022 lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e Procedurave për Funkionimin e Njësive Organizative për Gjoha dhe Ndëshkime [...], konstatoi se neni 12 i Rregullores së Administratës Tatimore të Kosovës mbi përcaktimin e procedurave për funksionimin e njësive organizative për gjoha dhe ndëshkime, që përcakton: *Nëse i pandehuri e paguan gjobën para se të marrë formën e prerë vendimi për kundërvajtjen, do të konsiderohet se në këtë mënyrë ka hequr dorë nga e drejta për paraqitjen e ankesës, shkel të drejtën për mjet juridik.* ”

Administrata Tatimore e Kosovës, në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, e ka ndryshuar rregulloren në fjalë.

## 6. E drejta e privatësisë

Avokati i Popullit ka pranuar 13 ankesa për shkelje të së drejtës së privatësisë, 7 prej të cilave janë hapur për hetim dhe janë dhënë rekomandime konkrete, sipas rasteve.

Lidhur me këtë të drejtë, Avokati i Popullit e ka trajtuar çështjen e instalimit të kamerave të sigurisë në disa qeli të të burgosurave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan. Kamerat e vendosura mbulonin vetëm shtretërit dhe dritaret e qelisë. Qëllimi i vendosjes së kamerave ka qenë për sigurinë e disa të burgosurave me probleme të shëndetit mendor.

“ Përkundër qëllimit të mirë, Avokati i Popullit vlerësoi se instalimi i kamerave në këtë rast paraqet ndërhyrje arbitrare në privatësi si dhe nuk ka një akt nënligjor konkret që do ta rregullonte një veprim të tillë. Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me rekomandim që vendosja e kamerave të këtë bazë ligjore të arsyetuar mirë, të cilin rekomandim Ministria e Drejtësisë e ka zbatuar. ”

## 7. E drejta e martesës dhe familjes

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2022, lidhur me këtë të drejtë ka pranuar 30 ankesa, 9 prej tyre janë proceduar për hetime të mëtejme. Kryesisht këto ankesa kishin të bënin me zvarritjet procedurale në gjykata, mospagimin e alimentacionit, mosnxjerrjen e urdhër-mbrojtjes, besimin e fëmijëve dhe realizimin e kontaktit me fëmijët kur prindërit jetojnë ndaras etj.



Çështja e pengimit të kontakteve të fëmijëve nën përkujdesjen e njërit prind, me prindin i cili është ndarë nga bashkësia familjare, vazhdon të jetë një problem shumë i rëndë. Në të shumtën e rasteve, për shkak të prishjes dhe të acarimit të skajshëm të raporteve ndër njerëzore midis ish-bashkëshortëve,, njërit prind i mohohet kontakti me fëmijët nga prindi tjetër. Avokati i Popullit u rekomandon institucioneve kompetente që në koordinim mes vete t'i ndër marrin të gjitha masat e nevojshme për adresimin e kësaj problematike.



## 8. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

Avokati i Popullit e vlerëson të rëndësishme ta theksojë se për gati një dekadë është bërë përpjekje për ndryshimin e ligjit ekzistues për liritë fetare. Pamundësia për ta ndryshuar këtë ligj paraqet një mungesë të bazës adekuate ligjore, e cila rregullon të drejtat fetare, e mbi të gjitha pozitën juridike të komuniteteve fetare. Miratimi i Ligjit të ri për Liritë Fetare, për Avokatin e Popullit përbën një të arritur të madhe për mbrojtjen dhe realizimin e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Lidhur me këtë të drejtë, gjatë këtij viti është zhvilluar një debat i gjerë publik që shkas ka marrë Udhëzimin Administrativ nr. 06/2014 Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënës të Shkollave të Mesme të Larta. Edhe pse udhëzimi administrativ nuk përcakton kufizim të bartjes së shamisë, debati kryesisht është zhvilluar për atë se a është e lejuar apo jo bartja e shamisë nëpër shkolla.



Në raportet e publikuara në vitet e mëhershme, Avokati i Popullit kishte konsideruar se Udhëzimi Administrativ nr. 06/2014 Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënës të Shkollave të Mesme të Larta nuk paraqet bazë të mjaftueshme ligjore për kufizimin e kësaj të drejte, duke u nisur nga parimi se kufizimi i të drejtave dhe i lirive mund të bëhet vetëm përmes një ligji të miratuar në Kuvend, kur ka një qëllim legjitim dhe përmbushen kriteret e përcaktuara me nenin 55 të Kushtetutës.



## 9. Liria e asociimit

Para fillimit të vitit shkollor 2022, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës kishte marrë vendim për fillimin e grevës. Duke pasur parasysh situatën e krijuar me grevën, Avokati i Popullit, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, më 15 shtator 2022 kishte mbajtur takime të ndara me përfaqësues të sindikatave dhe të Qeverisë, në përpjekje që nëpërmjet ndërmjetësimit të ndihmonte në zgjidhjen e situatës që ishte krijuar me grevën. Avokati i Popullit ka theksuar rëndësinë që ka respektimi i së drejtës për organizim sindikal dhe i së drejtës për veprime sindikale dhe gjithashtu ka ngritur shqetësimin dhe palëve ua ka rikujtuar se situata e krijuar me grevën në arsim ishte në dëm të fëmijëve dhe për çdo orë të humbur të mësimi, pasojat do të ishin të parikuperueshme për ta.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar 5 ankesa me pretendime për shkelje të Lirisë së asociimit.



Avokati i Popullit, në Raportin A. nr. 474/2021 lidhur me pretendimet për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit si anëtarë në Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, gjeti se nga mungesa e vullnetit të shprehur për bashkëpunim mes Autoritetit dhe shoqatës sindikale janë krijuar divergjenca dhe probleme me efekte zinxhimore dhe ka konstatuar se Autoriteti i Aviacionit Civil ka cenuar Lirinë e asociimit të Shoqatës Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Ndërsa në Raportin A. nr. 444/2021 lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, është konstatuar se disa dispozita të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk janë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike dhe janë në kundërshtim me parimet kushtetuese të sundimit të ligjit dhe të mosdiskriminimit dhe me të Lirisë së asociimit, me të drejtën për ushtrimin e profesionit dhe me parimet e Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është përgjigjur se do ta adresonte ndryshimin e këtij ligji.



## 10. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

Realizimi i të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve nga fusha e marrëdhënies së punës pos që ka një rëndësi të posaçme për statusin e çdo qytetari, është edhe një indikator i rëndësishëm se si shteti i realizon obligimet ndaj qytetarëve. Në lidhje me të drejtën në punë dhe të ushtrimit të profesionit, gjatë vitit 2022 Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej 54 ankesa. Në rastet e hetuara sipas ankesave të qytetarëve apo të iniciuara sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit ka trajtuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës, manifestimin e fesë në vendin e punës, mosrealizimin e së drejtës në pagë etj.

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka gjetur se si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat, vazhdon shkelja e së drejtës së punës dhe e ushtrimit të profesionit.



Gjatë shqyrtimit të rasteve në lidhje me të drejtën në punë dhe ushtrimin e profesionit, Avokati i Popullit gjeti: shkelje të procedurave të punësimit, ndërprerje të marrëdhënies së punës në kundërshtim me ligjin, moskompensimin për punën jashtë orarit, mosshfrytëzim të së drejtës për pushim vjetor, mosrealizimin e së drejtës në pagë, punëtorë pa kontrata të punës, diskriminim në moshë gjatë punësimit etj.



Shumë shqetësuese vazhdon të mbetet mbrojtja dhe siguria në punë. Statistikat e Inspektoratit të Punës tregojnë se numri i aksidenteve në vendet e punës që përfundojnë me fatalitet mbetet i lartë dhe mjaft shqetësues. Që nga viti 2004 deri në vitin 2021, sipas Inspektoratit të

Punës, në vendin e punës ose lidhur me punën kanë humbur jetën 232 persona. Vetëm gjatë vitit 2022, sipas të dhënave zyrtare në Kosovë, 14 persona kanë humbur jetën në vendin e punës, derisa 169 aksidente kanë përfunduar me lëndime të lehta, ndërsa 61 aksidente kanë përfunduar me lëndime të rënda. Gjithnjë, sipas të dhënave të Inspektoratit të Punës, vdekjet më të mëdha në vendin e punës identifikohen në sektorin e ndërtimit.

Për sa u përket lëndimeve në vendin e punës, Avokati i Popullit, krahas të tjerave, ka gjetur probleme në raportimin e këtyre rasteve.



Përkundër përcaktimit me ligj, njëri ndër problemet që mbetet evident është mosraportimi i aksidenteve në vendet e punës, sidomos i aksidenteve që si pasojë kanë lëndimin. Shqetësuese për Avokatin e Popullit mbetet mungesa e raportimeve mbi sëmundjet që lidhen me vendet e punës, shkaku i mungesës së rregullimeve specifike ligjore dhe i tërë sistemit që lidhet me Shëndetin në Punë.



## 11. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka pranuar 310 ankesa përkitazi me mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, 112 prej të cilave janë hapur për hetime.



Në bazë të ankesave dhe të rasteve të hetuara, Avokati i Popullitka gjetur se edhe në vitin 2022 në Sektorin Publik të Shëndetësisë: ka pasur mungesa të furnizimeve të rregullta me barna esenciale, produkte e pajisje medicinale si dhe materiale shpenzuese; ka vazhduar të ketë pritje të gjata të pacientëve për t'i kryer disa lloje intervenimesh; ka vazhduar largimi i profesionistëve shëndetësorë nga vendi - nga institucionet publike dhe nga ato private; Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor nuk ka gjetur zbatim të plotë; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nuk është pjesë e Kushtetutës; kujdesi paliativ akoma nuk është funksionalizuar; Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh) ende nuk është ngritur dhe si rrjedhojë kemi një SISh jo të plotë dhe jofunksional.



Në lidhje me problemin e mbledhjes dhe të raportimit të të dhënave shëndetësore, Avokati i Popullit, më 18 mars 2022, ka organizuar tryezë ku u diskutuan problemet kyçe në zinxhirin e grumbullimit dhe të raportimit të të dhënave, domosdoshmërinë për qartësimin e roleve institucionale përkitazi me përgjegjësitë në këtë aspekt dhe nevojën e një pune bashkëpunuese dhe koordinuese, për të pasur të dhëna të plota, të sakta, të besueshme dhe në kohë dhe rëndësia e funksionalizimit të SISh-it.

Për sa u përket pensioneve, bazuar në ankesat e pranuar, Avokati i Popullit ka gjetur se edhe më tej mbetet shqetësuese ndërprerja e pensionit të moshës për shkak të mosparaqitjes fizike çdo gjashtë muaj në zyrën e pensioneve, përmes të cilit fakt vërtetohet se personi është gjallë. Një praktikë e tillë është e papranueshme dhe paraqet shkelje të të drejtave të personave që përfitojnë nga skemat pensionale. Gjithashtu Avokati i Popullit vlerëson se kjo praktikë

cenon dinjitetin e pensionistëve dhe krijon vështirësi të theksuara për pensionistët, andaj ka rekomanduar të ndërpritet një praktikë e tillë.

## 12. Liria e shprehjes, e drejta e qasjes në dokumente publike dhe liria e mediave

Lidhur me lirinë e shprehjes, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar 5 ankesa, për 2 prej të cilave ka hapur hetime. Ndërlidhur me këtë të drejtë, Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim debatin e zhvilluar në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 16 mars 2022, në të cilën seancë, disa deputetë të Kuvendit kishin përdorur gjuhë të papërshtatshme ndaj komunitetit LGBTI+.



Lidhur me gjuhën e përdorur nga deputetët në seancën e Kuvendit, datë 16 mars 2023, Avokati i Popullit cilëson se kjo gjuhë e përdorur është në kundërshtim me vlerat themelore të një shoqërie demokratike, që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë dhe se këto vlera janë bazë themelore për funksionimin e shtetit të së drejtës.



Në Kosovë, e drejta për qasje në dokumente publike është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligj. Për shkelje të kësaj të drejte, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pranuar 14 ankesa, 3 prej të cilave (2 të parashtruar nga qytetarët dhe 1 nga mediat) janë hapur për hetim.



Në njërën nga ankesat e pranuar, që kishte të bënte me refuzimin e qasjes në shpenzimet e një diplomati, Avokati i Popullit, përmes raportit me rekomandim, kishte konstatuar se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) kishte dështuar t'i përmbushte detyrimet lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar. Për më tepër, Avokati i Popullit kishte konstatuar se mosveprimi i MPJD-së, edhe përkundër vendimeve që kishte nxjerrë Agjencia për Informim dhe Privatësi lidhur me çështjen, tregon për qasje mospërfillëse, duke mos i kushtuar vëmendje dhe rëndësi interesit të publikut për mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike dhe respektivisht së drejtës për qasje në dokumente publike.



Edhe pse gjatë vitit 2022 nuk janë pranuar ankesa në lidhje me cenimin e së drejtës së mediave, Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim çështjet që ndërlidheshin me sigurinë e gazetarëve, kameramanëve, fotoreporterëve dhe shtëpive mediale në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka raportuar për më shumë se 30 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, fotoreporterëve dhe kameramanëve dhe shtëpive mediale. Avokati i Popullit rekomandon që sulmet, kërcënimet dhe presionet ndaj gazetarëve duhet të marrin një përgjigje të shpejtë nga organet kompetente për të garantuar siguri dhe mbrojtje për ta, që të jenë të lirë ta ushtrorjnë profesionin e tyre.

### 13. Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes

Edhe pse viti 2022 nuk ka qenë vit zgjedhor, Avokati i Popullit ka vazhduar ta ngrejë çështjen e mospërfaqësimit të barabartë gjinor në listat e kandidatëve që garojnë në zgjedhje. Kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.

“ Më 27 shtator 2019, Avokati i Popullit ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë me kërkesë për masë të përkohshme përkitazi me shkeljen nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të së drejtës për trajtim të barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

Gjithashtu Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, ka lëshuar opinion në lidhje me emërimin e nënkryetarëve në komuna.

“ Nuk është juridikisht e argumentueshme të vlejë qëndrimi se nënkryetari për komunitete duhet të jetë pjesëtar i komunitetit më të madh joshumicë në një komunë të caktuar. Çfarëdo kufizimi në Udhëzimin Administrativ, sipas të cilit do t'i jepej përparësi ndonjërit nga komunitetet joshumicë për propozimin e nënkryetarit për komunitete i komunës, me arsyetimin se janë komuniteti joshumicë më i madh, e cenon të drejtën e komuniteteve të tjera joshumicë që ta propozojnë nënkryetarin për komunitete të komunës, konstatohet ndër të tjera në opinionin e Avokatit të Popullit.

### 14. E drejta për arsimim

Përgjatë vitit 2022 Avokati i Popullit ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave për sa i përket së drejtës për arsim, ndërsa 7 raste janë iniciuar sipas detyrës zyrtare. Në këto raste ndër të tjera Avokati i Popullit ka trajtuar: dhunën në shkolla, vijshmërinë në shkollë si dhe kushtet e mësimin për nxënësit romë, ashkalinj dhe egjiptianë, grevat në arsim, diskriminimin e fëmijës me aftësi të kufizuara, mungesën e transportit për fëmijë me aftësi të kufizuara, ndërprerjen e mësimin dhe kriteret për fitimin e gradave dhe titujve në universitete.

“ Përveç të tjerash, Avokati i Popullit, përmes Raportit nr.331/2022, i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të hartojë dhe zbatojë politika për ta përmirësuar cilësinë e arsimit, veçanërisht në fushën e matematikës, të shkencës dhe të leximit; të hartojë dhe zbatojë një strategji për ta përmirësuar pjesëmarrjen, cilësinë dhe njohjen e hershme të aftësisë së kufizuar në të paktën dy vjet të arsimit parashkollor (moshat 3 dhe 4), përfshirë përdorimin e ambienteve të shkollës për të hapur shërbime/grupe të edukimit parashkollor; si dhe të angazhohet drejtpërdrejt dhe t'i koordinojë politikat dhe praktikat me komunat dhe me shkollat për ta përmirësuar pjesëmarrjen në nivel të arsimit parashkollor.

## 15. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Sikurse edhe në vitet paraprake, Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2022 ka trajtuar me përkushtim të drejtat e aftësisë së kufizuar. Në mars të vitit 2022, Avokati i Popullit ka filluar fushatën “Barazi për të gjithë”. Kjo fushatë është mbajtur në 11 komuna të Kosovës. Qëllimi i këtyre tryezave ka qenë promovimi i mandatit të Avokatit të Popullit si dhe fuqizimi i bashkëpunimit me institucione publike, me shoqëri të civile, me media dhe me aktivistë të të drejtave të njeriut. Lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit ka gjetur se gjatë vitit 2022 pothuajse nuk evidentohet progres për sa i përket respektimit të këtyre të drejtave.

Përkundër ekzistimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe të ligjeve të tjera të veçanta, problematike mbetet mungesa e një ligji të harmonizuar dhe gjithëpërfshirës për trajtimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.



Avokati i Popullit ka gjetur se në fushën e respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si çështje sfiduese mbeten: 1. Moszbatimi i Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; 2. Rastet e dhunës ndaj fëmijëve dhe të të rriturve me aftësi të kufizuara; 3. Mospunësimi i personave me aftësi të kufizuara; 4. Mungesa e qasjes në infrastrukturë, veçanërisht në objektet e gjykatave dhe të prokurorive si dhe të qendrave për punë sociale nëpër komuna; 5. Vendimet shabllone të komisioneve mjekësore për refuzim të njohjes të së drejtës për pension apo ndërprerje të pensioneve; 6. Përkrahja e pamjaftueshme për personat me autizëm dhe e personave me zhvillim të vonshëm mendor; 7. Personat shtatshkurtër nuk janë përfitues të pensioneve; 8. Mungesa e qendrave për studentë me aftësi të kufizuara; 9. Mungesa e materialeve informuese në alfabetin e brailit etj.



Po ashtu, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), më 2 dhjetor 2021 ia kishte dërguar një mendim juridik Gjykatës Themelore në Prishtinë, që kishte të bënte me një ankesë individuale të ankuesit z. Faruk Kukaj, lidhur me pretendimet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Më 18 tetor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte aprovuar padinë e z. Kukajt, duke shënuar rastin e parë gjyqësor në Kosovë të gjykuar në bazë të pretendimeve për diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Për sa i përket arsimimit të personave me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit ka konstatuar se cilësia e arsimit nuk është në nivelin e duhur për t'i përgatitur nxënësit për jetë. Ndër të tjerash, Avokati i Popullit vlerëson se sistemi arsimor në Kosovë nuk ua mundëson nxënësve zhvillimin e potencialit sipas nevojave dhe aftësive të tyre, në pajtim me dispozitat kushtetuese.

## 8. MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI

Në kuadër të punës së tij, Avokati i Popullit i ka kushtuar kujdes të veçantë mbrojtjes së qytetarëve nga diskriminimi. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi e përcakton Avokatin e Popullit si institucion i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminim.



Për Avokatin e Popullit konsiderohet shqetësues fakti se raportimi i rasteve të diskriminimit mbetet akoma i vogël. Shumica e ankesave për diskriminim që paraqiten te Avokati i Popullit nuk rezultojnë me diskriminim, ndërsa rastet e vërteta të diskriminimit vazhdojnë të mos paraqiten apo denoncohen, sa nga mosnjohja e konceptit të diskriminimit, sa nga frika e viktimizimit, por edhe nga mungesa e besimit të qytetarëve në mekanizmat përgjegjës.



Në vitin 2022 Avokati i Popullit ka pranuar 75 ankesa me pretendime për diskriminim, derisa 6 raste të tjera janë hapur sipas detyrës zyrtare. Gjatë trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin, Avokati i Popullit ka adresuar shumë dimensione të kësaj çështjeje, siç janë: problemet e përgjithshme në fushën e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, aktet normative të cilat përbëjnë diskriminim dhe praktikat e përgjithshme që janë në kundërshtim me parimet e ndalimit të diskriminimit.

Gjatë vitit 2022 Avokati i Popullit ka publikuar 4 raporte me rekomandime, ku ka identifikuar dispozita të akteve normative që bien ndesh me parimin e mosdiskriminimit.

Ndër të tjerash, Avokati i Popullit, në **Raportin A. nr. 444/2021 lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim**, ka konstatuar se Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përmban dispozita që janë në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit.



Avokati i Popullit ka theksuar se kushtet për licencimin dhe ushtrimin e profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë objektive dhe të barabarta për të gjithë dhe nuk duhet të lidhen me natyrën e anëtarësimit të detyrueshëm në një organizatë ndërkombëtare.



Avokati i Popullit, në Raportin ex officio nr. 176/2020 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 10/2014 për Punën dhe Kriteret e Vendosijes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet, ka gjetur se Udhëzimi Administrativ nr. 10/2014 për Punën dhe Kriteret e Vendosijes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet përmban dispozita diskriminuese.



Udhëzimi Administrativ nr. 10/2014 vendos kushte në bazë të statusit familjar të parashtruesve të kërkesës për vendosje në Shtëpinë e Personave të Moshuar, mbi bazën e gjinisë dhe statusit martesor të pasardhësve të tyre apo lidhur me faktin nëse parashtruesit e kërkesës kanë bijë, bija të pamartuara apo të martuara. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit ka kërkuar ndryshimin e këtyre dispozitave të këtij udhëzimi administrativ.

Tutje Avokati i Popullit, në **Raportin A. nr. 125/2021 lidhur me kriterin diskriminues në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”**, ka gjetur dispozita që bien në kundërshtim me parimin e ndalimit të diskriminimit, ku Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” ua njeh përparësinë e kandidatëve që studimet i kanë përfunduar në UP në krahasim me kandidatët që studimet i kanë përfunduar në institucione të tjera të arsimit të lartë në Kosovë dhe në vende fqinje.

Kriteret e përcaktuara në këtë rregullore përbëjnë kufizime të paautorizuara me ligj dhe përbëjnë diskriminim mbi bazën e vendit apo të institucionit të arsimit të lartë publik dhe privat ku i kanë përfunduar studimet.

Siç u theksua edhe më sipër, në rastin e padisë së qytetarit z. Faruk Kukaj, kundër të Komunës së Prishtinës, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vërtetuar diskriminimin. Ky fakt për Avokatin e Popullit konsiderohet i rëndësishëm. Por, pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit ka gjetur se procedura gjyqësore në këtë rast nuk ishte zhvilluar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo pasi nga i padituri ishte kërkuar ta vërtetonte diskriminimin e tij, përkundër faktit se në rastin konkret, sipas ligjit, barra e provës bie mbi të paditurën, në rastin konkret, mbi Komunën e Prishtinës, dhe jo mbi paditësin.

Për sa i përket zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka pasur sfida të ndryshme, siç janë: 1. Ofrimi i asistencës ligjore viktimave të diskriminimit në hartimin e ankesave, ngase kjo bie ndesh me parimet dhe me dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit; 2. Mungesa e kompetencave të plota të Avokatit të Popullit në sektorin privat; 3. Mungesa e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi; 4. Paqartësia rreth autoritetit i cili nxjerr sanksione administrative; 5. Mosharmonizimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi me Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe mungesa e njohjes së faktit se Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi është ligj special (lex specialis) për çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin.

## 9. AVOKATI I POPULLIT SI MEKANIZËM KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKP).

Gjatë vitit 2022 ka realizuar 62 vizita, prej të cilave 20 vizita të përgjithshme, 19 vizita ad-hoc, 21 vizita përcjellëse, 1 vizitë tematike dhe 1 vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Këto vizita janë realizuar në stacionet policore, në qendrat e paraburgimit dhe në ato korrektuese, në institucionet e shëndetit mendor dhe në ato të kujdesit social, në shtëpitë integruese në bashkësi etj.

MKP-ja ka monitoruar aspektet e trajtimit të personave të privuar nga liria, duke përfshirë kushtet e mbajtjes, regjimin, shërbimet e ofruara, trajtimin shëndetësor, kategorizimin, konfliktet eventuale mes të paraburgosurve dhe të burgosurve, keqtrajtimin psikik dhe fizik, si dhe të gjitha aspektet e tjera, që ndërlidhen me trajtimin e kësaj kategorie të personave.

Avokati i Popullit ka pranuar mbi 240 thirrje telefonike nga personat e privuar nga liria si dhe ka realizuar më tepër se 244 intervista individuale dhe intervista të tjera grupore. Edhe gjatë vitit 2022, ankesat kryesisht kanë qenë të drejtuara kundër vendimeve gjyqësore, beneficioneve të ndryshme, lirimit me kusht, faljes, trajtimit shëndetësor etj. Avokati i Popullit ua ka adresuar autoriteteve kompetente 38 rekomandime konkrete. 8 prej këtyre rekomandime janë zbatuar plotësisht, 5 pjesërisht, derisa 25 të tjera janë në pritje të zbatimit. Autoritetet përgjegjëse janë përgjigjur në kohë për të gjitha rekomandimet e përcjella, për veprimet e ndërmarra dhe për ato që priten të ndërmerren.

“

Sfidë vazhdon të mbetet trajtimi dhe vendosja e personave me sëmundje mendore në qendrat e paraburgimit dhe në ato korrektuese, për shkak të mungesës së kapacitetit në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK)”, megjithatë “sfidë ka paraqitur edhe përzierja e kategorive të tjera të ndjeshme, si: personat e moshuar, personat me sëmundje të rënda, përdoruesit e substancave narkotike, me pjesën tjetër të personave të privuar nga liria”.

”

“

Institucionet korrektuese nuk kanë kapacitete të nevojshme për vendosjen dhe trajtimin e personave me çrregullime mendore, si dhe nuk kanë kapacitete njerëzore profesionale.

”

Megjithatë, MKP-ja nga monitorimet e realizuara konstaton se trajtimi i personave të privuar nga liria, në përgjithësi është në nivel të mirë dhe se nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik apo për mosrespektim të të drejtave themelore.

MKP-ja vlerëson se disa qendra korrektuese nuk i plotësojnë standardet që kërkohen për mbajtjen e personave të privuar nga liria, siç janë: Qendra e Paraburgimit në Pejë, Qendra e Paraburgimit në Prizren, Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, si dhe Shtëpia e Nënës dhe Foshnjës në Lipjan. Ndërsa Qendra Korrektuese në Dubravë ka nevojë të vazhdueshme për renovime.

MKP-ja gjatë monitorimeve të realizuara ka vërejtur se Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdon të ballafaqohet me mungesë të stafit korrektues dhe të zyrtarëve socialë. Lidhur me këtë gjendje, Avokati i Popullit ka rekomanduar të rritet numrit i stafit dhe në fund të vitit 2022 ka pasur ndryshime pozitive, pasi janë rekrutuar 50 zyrtarë të rinj korrektues dhe do të vazhdohet me punësimin edhe të një numri të konsiderueshëm.

## 10. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Krahas të drejtave të përgjithshme, fëmijët gëzojnë edhe të drejta të tjera, për shkak të nevojave të tyre specifike si fëmijë. Në vitin 2022, Avokati i Popullit ka pranuar 77 ankesa me pretendime për shkeljen e të drejtave të fëmijëve, në 54 prej të cilave ka hapur hetime. Krahas kësaj, Avokati i Popullit ka trajtuar edhe 9 raste sipas detyrës zyrtare.



Në lidhje me të drejtën e fëmijëve për arsim, Avokati i Popullit ka gjetur: Në dekadën e fundit Kosova ka shënuar progres në arsim, mirëpo ky progres ka qenë jo i barabartë në sektorë të ndryshëm për sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të fëmijëve, sipas nevojave dhe aftësive të tyre.



Për Avokatin e Popullit është e rëndësishme që në vitin 2019 Kosova kishte shënuar një hap kyç drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, përmes plotësimit të kornizës ligjore me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Por miratimi i këtij ligji mbetet vetëm akt simbolik nëse i njëjti nuk ndiqet me hapa konkretë për zbatim të suksesshëm. Ligji në fjalë obligon Qeverinë, Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës t'i miratojnë 18 akte nënligjore. Deri më tani këto institucione kanë miratuar vetëm 6 prej tyre. Andaj Avokati i Popullit konsideron se miratimi i këtyre akteve nënligjore është i një rëndësie të veçantë në zbatimin praktik të ligjit.

Në vitin 2022, në fokus të Avokatit të Popullit kanë qenë edhe të drejtat e fëmijëve në procedurat gjyqësore. Për këtë Avokati i Popullit ka trajtuar gjithsej 14 ankesa kundër gjykatave, të cilat kishin të bënin me besimin e kujdestarisë së fëmijëve dhe caktimin e alimentacionit, zvarritjen e procedurave gjyqësore për kompensim material për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara etj. Në dy prej këtyre rasteve, Avokati i Popullit u ka dërguar gjykatave rekomandime për trajtim me prioritet. Pas rekomandimit të Avokatit të Popullit, gjykatat kompetente iu kanë drejtuar Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me

kërkesë për të dhënë Opinion këshillëdhënës, duke kërkuar udhëzime se si duhet të veprohet kur ka rekomandime të Avokatit të Popullit që një lëndë të procedohet shpejt dhe pa vonesa.



Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka vendosur një standard të rëndësishëm përmes lëshimit të Opinionit Nr. 04/2022, ku i referohet rekomandimeve dhe argumenteve ligjore të prezantuara nga Avokati i Popullit. Ky Opinion këshillon gjyqtarët e tri niveleve të gjykatave të Republikës së Kosovës që në rastet e tilla ku në lëndët në pritje janë të përfshirë palë me status ligjor të fëmijës (përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara), duhet pa hezitim të merren me prioritet në trajtim edhe nëse në pritje ka lëndë më të vjetra.



Dhuna vazhdon të mbetet e pranishme në jetën e fëmijëve, ku si shqetësime janë ngritur përdorimi i ndëshkimit trupor fizik si mjet disiplinimi nga mësimmshënësit dhe ngacmimi mes bashkëmoshatarëve (bullizmi).

Avokati i Popullit ka gjetur se fëmijët me aftësi të kufizuara janë ende duke përjetuar vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj.



Avokati i Popullit ka iniciuar hetim sipas detyrës zyrtare bazuar në informatat e postuara nga televizioni “Klan Kosova”, me titull “Gjimnazi Hivzi Sylejmani në Fushë Kosovë nuk e pranon nxënësin, veç pse është në karrocë”.



Për sa i përket mbrojtjes sociale dhe shëndetësore të fëmijëve, Avokati i Popullit thekson se Kuvendi ende nuk e ka miratuar plotësim ndryshimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe as Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, pavarësisht rekomandimeve të dhëna në tri vitet e fundit.



Miratimi i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përmes të cilit do të rregullohej në tërësi mandati, roli, kompetencat, përgjegjësitë dhe struktura e qendrave për punë sociale, është shumë me rëndësi për mirëqenien e fëmijëve. Kjo është theksuar edhe në deklaratën e përbashkët me shoqërinë civile drejtuar autoriteteve qeveritare.



## 11. BARAZIA GJINORE

Barazia gjinore, sipas Kushtetutës, kategorizohet si vlerë. Fatkeqësisht, faktet tregojnë se gratë janë në një pozinë më pak të favorshme sesa burrat, në veçanti në fushën e punësimit dhe zhvillimit në karrierë për gratë me aftësi të kufizuara, gratë në një moshë të caktuar, gratë nga komunitetet joshumicë, gratë e zonave rurale, gratë shtatzëna dhe nënat e fëmijëve të mitur. Përkundër faktit se ligji u garanton trashëgimi si burrave ashtu edhe grave, Avokati i Popullit ka gjetur se gratë dhe vajzat në të shumtën e rasteve heqin dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve burra.



Avokati i Popullit vlerëson se korniza ligjore aktuale për mbrojtjen e barazisë gjinore në trashëgimi është e pamjaftueshme të përballet me praktikatat tradicionale, siç është heqja dorë prej trashëgimisë. Për këtë arsye, krahas të tjerave, Avokati i Popullit rekomandon ndërmarrjen e veprimeve për ngritjen e vetëdijes shoqërore në këtë fushë. Ky konstatim bazohet kryesisht në numrin e vogël të ankesave që Avokati i Popullit ka marrë për këtë çështje.



Edhe gjatë vitit 2022 problem vazhdon të mbetet dhuna në familje. Fatkeqësisht në shumë raste konstatohet se kjo ndodh si rezultat i dështimit të shtetit për t'i ndërmarrë obligimet pozitive. Përkundër faktit se Republika e Kosovës përmes amendamentit kushtetues e ka përfshirë në Kushtetutë Konventën e Stambollit, harmonizimi i legjislacionit me këtë konventë mbetet i ngadaltë.

Avokati i Popullit ka publikuar Raportin ex officio nr. 13/2022 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë dhe për të siguruar mbrojtje nga dhuna në familje, i cili është iniciuar sipas detyrës zyrtare, bazuar në raportimet e mediave se më 5 janar 2022, në fshatin Llaushë, komuna e Skenderaj, ishte gjetur e vrarë me armë zjarri një grua, duke theksuar se viktima dhe dorasi ishin bashkëshortë.



Raporti i Avokatit të Popullit, i datës 22.7.2022, konstaton mospërbushjen e detyrimeve pozitive nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur të drejtën për jetë. Sipas raportit, autoritetet dështuan t'i ndërmerrnin një sërë veprimesh dhe atë: nuk kanë respektuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; nuk e kanë trajtuar me vëmendjen e duhur rastin dhe nuk i kanë ofruar mbrojtje adekuate viktimës; ka munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, prokurori i rastit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pavarësisht faktit se është vënë në dijeni për rastin, nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për vlerësimin e rrezikut dhe masave të sigurisë për viktimën.



Po ashtu, Avokati i Popullit ka ritheksuar vazhdimisht shqetësimin për moszbatimin e Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës. Qeveria është zotuar se do të ndajë buxhet për zbatimin e këtij ligji.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2022 ka trajtuar edhe çështjet të cilat ndërlidhen e gratë viktime të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës, me ç' rast ka vlerësuar:



Grave viktime/të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë duhet t'u sigurohet përkrahja institucionale dhe financiare e nevojshme, paralelisht me rritjen e vetëdijesimit të shoqërisë për heqjen e paragjytimeve mbi këtë grup.



## 12. PËRGJEGJËSIA PËR MJEDISIN JETËSOR

Përkritazi me të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, Avokati i Popullit në vitin 2022 ka pranuar gjithsej 15 ankesa. Avokati i Popullit konstaton se përkundër rëndësisë që ka mbrojtja e mjedisit, si e drejtë e njeriut, autoritetet përgjegjëse nuk kanë arritur t'i përmbushnin obligimet e tyre pozitive sipas kësaj të drejte.

Lidhur me përgjegjësinë për mjedisin jetësor, është pozitiv fakti se gjatë vitit 2022 është miratuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Përkundër kësaj, shqetësues mbetet kualiteti i ajrit dhe ndikimi në të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.



Avokati i Popullit konstaton se institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e ajrit vazhdojnë me mospërmbushje të kërkesave ligjore dhe me mosndërmarrje të masave adekuata në uljen e ndotjes së ajrit.



Mbrojtja e ujërave sipas parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm vazhdon të jetë një sfidë serioze. Ndërhyrjet e pakontrolluara, pa kriter, të operatorëve për eksploatin e rërës dhe zhavorrit në segmentet e ndryshme të shtretërve të lumenjve dhe të brigjeve të tyre kanë vazhduar, duke shkaktuar mjedis të pasigurt për jetën e qytetarëve si dhe mungesë të ujërave. Po ashtu, ende kanë vazhduar paqartësitë me operimin e hidrocentraleve.



Avokati i Popullit konstaton se edhe pse Kosova është ndër vendet më të varfra me burime ujore, nuk janë ndërmarrë veprime konkrete të cilat do ta ndalnin degradimin e vazhdueshëm të lumenjve në aspektin tredimensional: uji, shtretërit dhe brigjet e lumenjve.



Praktika e mosrespektimit të kriterëve të caktuar me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe me Ligjin e Ndërtimit është çështje që kërkon trajtim të shpejtë dhe politika të qarta institucionale për ndryshim.



Avokati i Popullit konstaton se degradimi, ndotja, betonimi dhe ndryshimi pa kriter i tokave ka vazhduar me ritëm të njëjtë.



Për sa i përket cenimit të privatësisë nga zhurma, është gjetur:



Edhe në këtë vit institucionet nuk kanë arritur ta vinin nën kontroll mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve nga zhurma dhe bezdia e krijuar nga zhurma.



Me qëllim të sensibilizimit të publikut lidhur me rëndësinë e ujërave, Avokati i Popullit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, më 27 qershor 2022, kanë organizuar tryezën: “Ujërat, e drejtë e njeriut – mbikëqyrja dhe llogaridhënia”.

## 13. TË DREJTAT E KOMUNITETEVE JOSHUMICË

Avokati i Popullit ka gjetur se realizimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë në praktikë ka hasur në sfida të konsiderueshme. Vetëm gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka pranuar 144 ankesa nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, me pretendime për shkelje të të drejtave të tyre.

Të dhënat e Komisionarit të Lartë për Refugjatë theksojnë se gjatë vitit 2022 në Kosovë janë kthyer 204 persona nga komuniteti joshumicë.

Edhe gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka gjetur se të zhvendosurit, refugjatët si dhe qytetarët e katër komunave veriore ballafaqohen me probleme lidhur me sigurimin e dokumenteve personale.



Avokati i Popullit konstaton se ka një progres të theksuar për sa i përket adresimit të çështjeve të cilat ndërlidhen me të drejtën e pronës që u përket komuniteteve joshumicë. Përkundër kësaj, Avokati i Popullit thekson se është ende e nevojshme që shteti të merret me çështjet pronësore të komuniteteve joshumicë, në mënyrë që të gjithë personat, pronat e të cilëve janë të uzurpuara, të mundë t'i gëzojnë ato në mënyrë të papenguar.



Fusha e arsimit është një problematikë tjetër, nga e cila sfidohen të drejtat e komuniteteve joshumicë. Dallimet në shtrirjen e sistemit arsimor konsistojnë në atë se nga Qeveria e Republikës së Kosovës menaxhohet arsimi në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake, derisa jashtë këtij rregullimi funksionon arsimi për komunitetin serb dhe, pjesërisht, për atë boshnjak dhe goran.



Avokati i Popullit edhe këtë vit rithekson se si pasojë e formës së menaxhimit të sistemit arsimor nga Qeveria, nxënësit që përfundojnë shkollimin në sistemin paralel nuk mund ta vazhdojnë atë sipas sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, për shkak të mosnjohjes së diplomave.



Duhet theksuar se Avokati i Popullit edhe më parë ka raportuar për problemet e komunitetit turk dhe boshnjak në lidhje me tekstet shkollore.



Problemi me tekstet shkollore të komunitetit turk dhe boshnjak u zgjidh përfundimisht gjatë vitit 2022. Tekstet e librave në gjuhën boshnjake dhe turke janë përzgjedhur dhe librat janë miratuar nga MASHTI për shtyp.



Përkundër garantimit me Kushtetutë dhe me ligj, për shkak të mungesës së kapaciteteve, komunitetet joshumicë kanë vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre gjuhësore. Këto probleme janë evidente si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal.



Në lidhje me të drejtat gjuhësore, Avokati i Popullit ka konstatuar se Komuna e Gjakovës ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, pasi ankueses në komunikim zyrtar i është drejtuar vetëm në gjuhën shqipe.



Po ashtu vazhdon praktika që disa faqe zyrtare të Qeverisë vetëm pjesërisht ofrojnë informacione bazë në gjuhën serbe dhe vetëm pjesërisht janë të qasshme dhe të përditësuara.

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit, bazuar në mandatin e tij, në forma të ndryshme ka komunikuar me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për t'i trajtuar çështjet e adresuara. Me këtë rast, Avokati i Popullit ka gjetur se është shumë shqetësues fakti se pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk janë të informuar mbi mekanizmat dhe procedurat për mbrojtjen e tyre nga diskriminimi.

Po ashtu, për sa u përket komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, Avokati i Popullit e sheh si problematik faktin e mungesës së gjithëpërfshirjes së tyre në arsim. Përkundër progresit



të shënuar në shkollimin fillor, përfshirja e këtyre komuniteteve në nivele të tjera të arsimit mbetet mbrapa komuniteteve të tjera.

## 14. DREJTËSIA TRANZICIONALE

Si çdo shoqëri e dalë nga lufta, edhe në Kosovë janë të domosdoshëm mekanizmat të cilët garantojnë drejtësinë tranzicionale, që i referohet katër objektivave kryesore: 1) Të drejtës për drejtësi, 2) Të drejtës për të ditur, 3) Të drejtës në reperacione dhe 4) Garantimit të mospërsëritjes.



Lidhur me drejtësinë tranzicionale, Avokati i Popullit ka gjetur se për dy dekada janë bërë përpjekje të ndryshme, por këto përpjekje janë zhvilluar pa një strategji gjithëpërfshirëse. Nismat e ndryshme nuk kanë qenë çdoherë të harmonizuara njëra me tjetrën dhe kjo ka ndikuar në mosarritjen e rezultateve të synuara.



Pamundësisë për realizimin e drejtësisë për krimet e luftës i ka kontribuar mungesa e performancës, si e institucioneve të drejtësisë ndërkombëtare në Kosovë, ashtu edhe e institucioneve kompetente kosovare. Nga viti 1999 e deri në vitin 2022 janë akuzuar për krime lufte gjithsej 117 persona dhe vetëm 45 prej tyre (35 shqiptarë, 9 serbë dhe 1 rom) janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme.



Ndër të tjera, në lidhje me trajtimin e krimeve të luftës, Avokati i Popullit konstaton: 1. Strategjia e KPK-së për krime lufte nuk i ka dhënë rezultatet e synuara. 2. Bashkëpunimi eventual me prokuroritë për krime të luftës nga rajoni, me theks të veçantë me atë të Serbisë, do ta hapte mundësinë për ndjekjen penale të atyre që kanë kryer krime lufte në Kosovë dhe që jetojnë në Serbi. 3. Për shkak të vështirësive që mbart, gjykimi në mungesë nuk duket zgjidhje e mjaftueshme për zbardhjen e krimeve të luftës.



Qytetarët, e posaçërisht viktimat, meritojnë ta mësojnë të vërtetën se çfarë ka ndodhur. Në këtë drejtim, për Avokatin e Popullit si shumë shqetësues vazhdon të mbetet fakti se nuk dihet fati i mbi 1600 personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Nuk janë identifikuar rreth 300 mbetje mortore, të cilat gjenden në Institutin e Mjekësisë Ligjore, që paraqet rreth 20% të numrit të personave të zhdukur.



Institucionet e shtetit kanë ndërmarrë nisma në drejtim të realizimit të së drejtës së viktimave dhe të qytetarëve për ta ditur të vërtetën mbi të kaluarën, mirëpo asnjëra nga këto nisma nuk i ka dhënë rezultatet e pritura. Ende është shumë larg hartimi i një narrativi zyrtar të saktë dhe gjithëpërfshirës mbi krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të ndodhura gjatë luftës në Kosovë.



Për sa i përket së drejtës në reparacione, institucionet kanë bërë përpjekje për shumicën e kategorive të viktimave të krimeve të luftës.



Avokati i Popullit konstaton se ngritja e memorialeve që u kushtohen viktimave të luftës së viteve 1998-1999 duhet të rregullohet me një ligj të posaçëm dhe të fuqizohet Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale. Kërkohej të bëhet shënjimi i hapësirave publike dhe jopublike ku ka pasur shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe krime të luftës. Po ashtu është i papranueshëm fakti që shteti i Kosovës ende nuk e ka krijuar një muze, i cili i kushtohet luftës dhe viktimave civile të saj.



## 15. MBIKËQYRJA E POLITIKAVE LEGJISLATIVE

Edhe gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit, nën prizmin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, ka analizuar politikën legjislative. Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2022 ka planifikuar miratimin e 150 ligjeve, kurse Kuvendi ka miratuar 110 ligje.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Ligji nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese nga partitë politike. Përkitazi me këtë ligj, Avokati i Popullit ka dërguar komentet në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.



Për sa i përket Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Avokati i Popullit vlerëson se procedura e zhvilluar deri në miratimin e këtij ligji është treguese e një praktike jo të mirë të hartimit dhe miratimit të ligjeve. Kjo për faktin se mospublikimi i vlerës së koeficientit në periudhën gjatë hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjit në fjalë ka shkaktuar paqartësi të subjektet që janë prekur nga fushëveprimi i këtij ligji.



Avokati i Popullit ngrehur shqetësimin se në momentin e publikimit të një ligji të tillë në Gazetën Zyrtare, i njëjti nuk publikohet në rubrikën e secilit ligj që e ndryshon dhe e plotëson, por publikohet vetëm në një faqe, duke e bërë kështu shumë të vështirë identifikimin e ndryshimeve ligjore.



Avokati i Popullit vlerëson se mospublikimi i ligjeve të cilat ndryshojnë disa ligje, në secilën rubrikë të ligjeve të cilat ndryshohen, i vë në vështirësi zbatuesit e ligjit për t'i identifikuar ndryshimet e miratuara. Një praktikë e tillë rezulton me paqartësi dhe njëkohësisht pasiguri te qytetarët që i afekton ligji.



## 16. GJENDJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË E PËRMBLEDHUR NË DISA KONKLUZIONE

Sipas rasteve të pranuar, pas hetimeve të zhvilluara nga Avokati i Popullit, në bazë të ankesave të pranuar apo hetimeve sipas detyrës zyrtare, si dhe duke u bazuar në tërësinë e mandatit të tij, Avokati i Popullit në vijim paraqet gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, përmes disa konkluzioneve.

1. Pamundësia e sistemit të drejtësisë për t'i përfunduar lëndët brenda një afati të arsyeshëm kohor paraqet një ndër problemet kryesore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Përpos që zvarritjet procedurale cenojnë të drejtën për gjykim të drejtë, element i së cilës është gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor, zvarritjet procedurale pamundësojnë edhe zbatimin e shumë të drejtave të tjera të qytetarëve të cilat garantohen me Kushtetutë. Përkitazi me këtë, për qytetarët e Kosovës ende nuk ekziston një mekanizëm për realizimin e dëmshpërblimit të tyre, për shkak të shkeljes së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.
2. Gjatë vitit 2022 janë evidentuar shkelje të dinjitetit të njeriut. Kjo shkelje është manifestuar, veçanërisht, në raport me grupet e cenushme, personat e moshuar pa përkujdesje familjare dhe personat me aftësi të kufizuara.
3. Shqetësuese mbetet mungesa e një ligji të harmonizuar dhe gjithëpërfshirës për trajtimin e të drejtave të aftësisë së kufizuara, moszbatimi i Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, rastet e dhunës, mospunësimi i tyre, mungesa e qasjes në infrastrukturë, përkrahja e pamjaftueshme për personat me autizëm dhe i personave me zhvillim të vonshëm mendor etj.
4. Raportimi i rasteve të diskriminimit mbetet akoma i vogël, shumica e ankesave për diskriminim që paraqiten te Avokati i Popullit nuk rezultojnë me diskriminim, ndërsa rastet e vërteta të diskriminimit vazhdojnë të mos paraqiten apo të mos denoncohen sa nga mosnjohja e konceptit të diskriminimit, sa nga frika e viktimizimit, por edhe nga mungesa e besimit të qytetarëve te mekanizmat kompetentë.
5. Barazia gjinore vazhdon të mbetet sfidë. Gratë vazhdojnë të përballen me probleme të theksuara në fushën e punësimit, të trashëgimisë etj. Dhuna në familje vazhdon të mbetet shqetësim. Përmasat e kësaj dukurie tregojnë më së miri se duhet mobilizim i përgjithshëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Fatkeqësisht, në shumë raste konstatohet se kjo ndodh si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve pozitive të shtetit.

6. *Për sa u përket të drejtave të personave të privuar nga liria, në qendrat e mbajtjes në Policinë e Kosovës dhe në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit nuk ka ankesa nga personat e arrestuar, të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitave nga Avokati i Popullit. Të gjithë të paraburgosurit e mitur që janë intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës.*
  - 6.1. *Shqetësues mbetet trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor, për shkak të mungesës së kapaciteteve në institucione të shëndetit mendor, si dhe mbajtja e tyre në institucione korrektuese.*
  - 6.2. *Gjithashtu trajtimi i personave të moshuar, i personave me probleme shëndetësore kronike, i atyre me nevoja të veçanta, me probleme të varësisë etj., të cilët janë në vuajtje të dënimit, mbetet sfidë për institucionet.*
  - 6.3. *Disa qendra korrektuese nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për punë dhe as për trajtim të dinjitetshëm të personave të privuar nga liria.*
7. *Mungesa e materialit për shtypjen dhe pajisjen me pasaporta të qytetarëve ka cenuar lirinë e lëvizjes. Gjithashtu vendosja e barrikadave në rrugë në veriun e Republikës së Kosovës ka paraqitur pengesë për lirinë e lëvizjes në këto zona.*
8. *Mbrojtja e pronës sfidohet nga mungesa e efikasitetit të gjyqësorit, për shkak të mosarritjes për të vendosur në mënyrë efikase për këto raste.*
9. *Vazhdon të mbetet sfidë realizimi i të drejtave të punës dhe të ushtrimit të profesionit si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat, si pasojë e shkeljeve të procedurave të punësimit, ndërprerjes së marrëdhënies së punës në kundërshtim me ligjin, moskompensimit të punës jashtë orarit, mosshfrytëzimit të së drejtës për pushim vjetor, mosrealizimit të së drejtës në pagë, punës pa kontratë, diskriminimit në moshë etj. Mungesa e sigurisë së punë vazhdon të mbetet shumë shqetësuese.*
10. *Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale sfidohet nga mungesa e furnizimeve të rregullta me barna esenciale, me produkte e pajisje medicinale si dhe me materiale shpenzuese, pritjet e gjata të pacientëve për t'i kryer disa lloje të intervenimeve, moszbatimi i Ligjit nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, mosfunktionalizimi i kujdesit paliativ etj.*
11. *Avokati i Popullit, në dhjetor 2022, ka adresuar Raportin Ex-officio nr.577/2021 lidhur me të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues (ShSR), me fokus në qasjen në informata dhe në shërbime për kontracepsion, për abort dhe për kujdes pas abortit, si dhe për kujdesin për shëndetin e nënës, i cili ka rezultuar me 536 rekomandime. Sipas Raportit, gratë dhe vajzat vazhdojnë të kenë mungesë informacioni e edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe për të drejtat që u takojnë, cenim të privatësisë dhe të konfidencialitetit, trajtim të*

padinjitetshëm, mungesë të dedikimit të kohës për pacient, vonesë në ofrimin e shërbimeve të nevojshme, vonesë për diagnostikim dhe trajtim me kohë, mungesë të herëpashershme të terapisë për trajtimin e sëmundjeve malinje të sistemit riprodhues etj. Ndërsa sipas të gjeturave, sistemi shëndetësor ka mungesë të mbikëqyrjes dhe të kontrollit të shërbimeve dhe të cilësisë së tyre, anomali në funksionim dhe mungesë koordinimi dhe planifikimi.

Avokati i Popullit, autoriteteve përgjegjëse ua ka rikujtuar detyrimet ligjore që ato kanë për respektimin e të drejtave të grave dhe të vajzave për shëndet seksual dhe riprodhues dhe njëherësh u ka rekomanduar t'i ndërmarrin të gjitha masat për mënjanimin e këtyre shkeljeve, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për ShSR-në, mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre institucioneve shëndetësore.

12. Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve vazhdojnë të mbeten shqetësim.
13. Kosova ka shënuar hapa të rëndësishëm drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, përmes plotësimit të kornizës ligjore me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Megjithatë miratimi i këtij ligji nuk është ndjekur me hapa konkret për zbatim të suksesshëm si pasojë e mosmiratimit të akteve nënligjore. Në dekadën e fundit Kosova ka shënuar progres në arsim, mirëpo ky progres ka qenë jo i barabartë në sektorë të ndryshëm për sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të fëmijëve, sipas nevojave dhe aftësive të tyre.
14. Për sa i përket së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, është pozitiv fakti se gjatë vitit 2022 është miratuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Përkundër kësaj, kualiteti i ajrit mbetet shqetësim. Avokati i Popullit konstaton se, edhe pse Kosova është ndër vendet më të varfra me burime ujore, nga institucionet kompetente nuk janë ndërmarrë veprime konkrete, të cilat do ta ndalnin degradimin e vazhdueshëm të lumenjve në aspektin tredimensional: uji, shtretërit dhe brigjet e lumenjve.
15. Edhe pse sistemi juridik kosovar ka garantuar të drejta të zgjeruara ndaj komuniteteve joshumicë në Kosovë, realizimi i këtyre të drejtave në praktikë has në sfida të konsiderueshme, bazuar në numrin e madh të ankesave të pranuar nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Shqetësim për Avokatin e Popullit mbetet mosinformimi i komuniteteve joshumicë: rom, ashkali, egjiptian, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi si dhe përfshirjen e tyre në arsim.
16. Përkundër përpjekjeve të ndryshme lidhur me drejtësinë tranzicionale, ka munguar një strategji gjithëpërfshirëse. Nismat e ndryshme nuk kanë qenë çdoherë të harmonizuara njëra me tjetrën dhe kjo ka ndikuar në mosarritjen e rezultateve të synuara.



PËRMBLEDHJE E  
RAPORTIT VJETOR  
2022

